



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 11 Maj 2023

Nr: 489

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 365 ID, NGA KOALICIONI PËR
REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA NDAJ
ZËVENDËSDREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË PËR MEDIA DHE INFORMIM
(MIA), PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 11 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjet administrative me:

- KËRKUES:** Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)
- SUBJEKT:** Z. Alteo Hysi, Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm pranë Agjencisë për Media dhe Informim (MIA)
- OBJEKT:** Shqyrtimi administrativ ndaj personave përgjegjës për shkelje administrative, për postime, ripostime dhe përdorim hashtag në faqen e rrjetit social "Facebook"
- BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, neneve 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) ka depozituar, denoncimin për të cilin pretendon se Agjencia e Medias dhe Informimit (MIA), ka publikuar

Data: 11 Maj 2023

Nr: 489

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 365 ID, për shkelje administrative"

në rrjetin social "Facebook", të institucionit, pastime që shoqërohen me slogane politike dhe një aktivitet elektorale.

Denoncimi është administruar, nëpërmjet raportit të KRIIK, të datës 2 Maj 2023, "Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 21- 27 Prill 2023".

Neni 19, pika 1, shkronja "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe u vlerësua se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t'u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, filloi shqyrtimi administrativ, duke verifikuar provat si dhe duke kërkuar informacion në lidhje me publikimet e postuara apo ripostimet me përmbajtje elektorale, slogane dhe # hashtag.

Denoncuesi ka paraqitur pretendime si më poshtë vijon:

Denoncim regjistruar me nr. 365 ID, ndaj Agjencisë për Media dhe Informim, me kërkesë KRIIK, ku pretendohet si më poshtë vijon:

"Evidentohen se postimet në faqen zyrtare të Agjencisë për Media dhe Informim (MIA), një institucion në varësi të Kryeministrit, shoqërohen me sloganë politike të Partisë Socialiste, ndërkohë që është postuar gjithashtu edhe një aktivitet elektorale i kësaj partie, me praninë e Kryeministrit Rama. Më datë 12 Prill 2023, Kryeministri Rama ka marrë pjesë në një aktivitet elektorale në Bashkinë e Durrësit, në praninë e Kryebashkiakes dhe kandidatës aktuale për Bashkinë Durrës nga Partia Socialiste, znj. Emiriana Sako.

Ky aktivitet elektorale është prezantuar si i tillë nga pjesëmarrësit në takim. Gjithashtu, aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së si aktivitet institucional."

Data: 11 Maj 2023 Nr: 489
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 365 ID, për shkelje administrative"

Përsa i përket postimeve në faqen zyrtare të Agjencisë për Media dhe Informim, në momentin kur denoncimi është administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezultoi se postimi objekt i këtij denoncimi nuk gjendej në faqen zyrtare të këtij institucioni.

Pavarësisht këtij fakti, të ndodhur në kushtet që nga ana e denocuesit është depozituar materiali provues foto, më datë 2.5.2023 nëpërmjet postës elektronike është kërkuar informacion lidhur me çështjen objekt denoncimi.

Më datë 8.5.2023 Agjencia për Media dhe Informim ka sqaruar se, *“Aktiviteti elektoral i datës 12 prill 2023 i shoqëruar me sloganet politike të partisë socialiste është postuar në faqen zyrtare të MIA-s në kanalin facebook, si rrjedhojë e një gabimi sa teknik, aq edhe njerëzor nga personi përgjegjës pranë Agjencisë për Media dhe Informim. Menjëherë pas evidentimit të këtij gabimi janë marrë masat për heqjen e videos nga faqja zyrtare. Në cilësinë e Zëvendësdirjtorit të Përgjithshëm të Agjencisë u kam tërhequr vëmendjen drejtuesve të Drejtorive pranë MIA-s për të qenë të kujdesshëm në respekt të Kodit Zgjedhor.”*

Në përfundim të hetimit administrativ, vlerësoj se:

Referuar nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor ku parashikohet se ***nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve publike***, denocuesi pretendon se ripostimi i materialit me përmbajtje elektorale në faqen zyrtare facebook të institucionit publik, përbën përdorim të burimeve publike. Megjithatë, të ndodhur në kushtet që në momentin e administrimit të denoncimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk arriti të vërtetojë dhe sigurojë provën objekt shqyrtimi, si dhe duke marrë parasysh faktin që postimi ka ndodhur për shkaqe të një gabimi njerëzor.

Duke qënë se institucioni publik ka reaguar në mënyrë të menjëhershme duke vetrregulluar pasojat e mundshme të ardhura nga postimi, vlerësoj se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ.

Për sa më sipër në mbështetje të fakteve të administruara gjatë shqyrtimit administrativ rezultoi se për rastin objekt denoncimi regjistruar me nr. **365 ID** vlerësohet se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe duhet t'i tërhiqet vëmendja të personave përgjegjës në mënyrë që të tregohet kujdes në publikimin e postimeve të ndryshme që përmbajnë slogane apo hashtag # me përmbajtje elektorale.

PËR KËTO ARSYE:

Data: 11 Maj 2023 Nr: 489
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 365 ID, për shkelje administrative”

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenin 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

V E N D O S:

1. Moskonstatimin e shkeljes dhe pushimin e shqyrtimit administrativ ndaj z. Alteo Hysi, Zëvendës drejtori i Përgjithshëm pranë Agjencisë për Media dhe Informim (MIA).
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 4

Afati i ruajtjes: 5 vjet

Punoi:

I.Horanlliu _____

M.Koja _____

A. Lamçe _____

Y.Merkaj _____

Data: 11 Maj 2023 Nr: 489
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 365 ID, për shkelje administrative”